



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Java Kundër
KORRUPSIONIT
3-9 DHJETOR 2017

AKUZAT PUBLIKE TË HASHIM REXHEPIT, TË PADËGJUARA NGA PROKURORIA



#bashkeendreqim #UnitedAgainstCorruption #KS

Koalicioni i OJQ-ve "Java Kundër Korrupsionit 2017" përbëhet nga:
IKD, GLPS, ÇOHU, GAP, INPO, KIPRED dhe COLUMBUS



GRUP PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE



INSTITUTE FOR
POLICY STUDIES **gap**



INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVO LAW INSTITUTE
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE



Prishtinë, Dhjetor 2017

Autor: Instituti i Kosovës për Drejtësi

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.



Ky projekt është mbështetur përmes grantit nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Prishtinë. Mendimet, të gjeturat dhe konkluzionet apo rekomandimet e shprehura janë të autorit dhe domosdoshmërisht nuk reflektojnë ato të Departamentit të Shtetit.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci
Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Dhjetor 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

Hulumtimet janë përkrahur nga:



British Embassy
Pristina



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive	3
II.	Përshkrim i rastit	3
III.	Gjetjet konkrete.....	6
IV.	Pyetje publike.....	6

I. Përmbledhje ekzekutive

Ish-Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, z. Hashim Rexhepi ishte arrestuar me 23 korrik 2010 nga policia në prani të mediave. Arrestimi dhe bastisjet ndaj ish-Guvernatorit ndërlidheshin me një hetim financiar për korrupsion ku dyshohej për keqpërdorim të detyrës apo pozitës zyrtare, marrje të ryshfetit, shmangie të tatimit, ushtrim të ndikimit dhe shpërlarje të parave. Pas katër muajve sa ishte mbajtur në paraburgim, në dhjetor të vitit 2011, ish-Guvernatori Hashim Rexhepi ishte liruar si i pafajshëm nga ish-Gjykata e Qarkut në Prishtinë.

Gjithë këtë spektakël të arrestimit dhe akuzimit pa bazë, ish-Guvernatori Hashim Rexhepi e ndërlidh me refuzimin, siç ka thënë ai, për tu korrumpuar në forma të ndryshme. Këto oferta të korrupsionit, sipas tij, i ishin ofruar nga këshilltari izraelit i Presidentit aktual aso kohe Kryeministri Hashim Thaçi. Përveç kësaj oferte, Rexhepi ka denoncuar ndërhyrjet në BQK, të cilat sipas tij, ishin bërë nga ish-Kryeministri Hashim Thaçi dhe njerëzit e tij të afërt, e deri tek ish-Kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku dhe ish-Komandanti i përgjithshëm i UÇK-së Azem Sylja.

Hashim Rexhepi ka rrëfyer se akterë kryesor në këto zhvillime kishin qenë ish-Ministri i Financave të Kosovës, Ahmet Shala dhe Besim Beqaj, aso kohe Kryesues i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Sipas tij, madje Ahmet Shala del të jetë iniciator i takimit në Londër mes tij (Hashim Rexhepi) dhe këshilltarit izraelit të Hashim Thaçit, në vitin 2010 pak ditë para se Rexhepi të arrestohej. Këshilltari izraelit i kishte thënë Hashim Rexhepit, se Banka Qendrore menaxhon mbi 1 miliard euro, dhe do të ishte mirë që ato të investohen në bankat që ia propozon ai, duke ia bërë me shenjë se të gjithë do të ndaheshin të kënaqur, në kuptim të përfitimeve materiale. Rexhepi thotë ta ketë mohuar këtë ofertë, duke i thënë që ta harronte se kanë biseduar për një gjë të tillë.

Ish-Guvernatori Rexhepi, kishte denocuar edhe Sami Lushtakun dhe Azem Sylën, lidhur me ndërhyrjet e tyre në BQK. Sami Lushtaku kishte kërkuar nga Hashim Rexhepi licencimin e kompanisë së sigurimeve “Europa Inc”, e cila ishte bllokuar për shkak të prejardhjes së dyshimtë të kapitalit dhe problemeve ligjore të aksionarëve. Ndërsa, Azem Sylja kishte kërkuar punësimin e njerëzve të tij në BQK.

Pak ditë para se të arrestohej, ish-Guvernatori Hashim Rexhepi, ishte informuar nga vartësit e tij për një investim të dyshimtë të parave të pensioneve në një institucion financiar jashtë vendit. Bëhet fjalë për 75 milionë euro në Fondin “Fortis”, kompania amë e të cilit, në momentin kur u investuan mjetet, në vitin 2010, ishte pranë falimentimit dhe po mbahej në jetë vetëm falë ndërhyrjes se qeverisë belge. Sipas Rexhepit, me t’i marrë këto informata, kishte urdhëruar stafin e tij për një inspektim të detajuar rreth këtij rasti, por ky hetim nuk ishte kryer asnjëherë, ndërsa ai (Hashim Rexhepi) meqë nuk i kishte kryer këto shërbime, ishte arrestuar dhe akuzuar.

Këto akuza të ish-Guvernatorit Hashim Rexhepi janë bërë publike në Gazetën Fjala. Ndërkohë, prej 17 qershorit 2015, në pajtim me nenin 11, pika 7 dhe neni 12 pika 3 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, Kryeprokurori i Shtetit kishte krijuar “Komisionin” për përcjelljen ditore dhe verifikimin e pretendimeve të rasteve të supozuara të krimit të organizuar e të korrupsionit, të publikuara përmes mjeteve elektronike e të shtypit, të parashtresave të qytetarëve dhe

paraqitjeve publike të zyrtarëve të organeve e organizatave shtetërore e publike dhe të organizatave joqeveritare”.

Prokurori i Shtetit nuk ka kthyer përgjigje nëse është iniciuar ndonjë hetim për këtë rast. Ndërkohë, autorët e intervistës me ish-Guvernatorin Hashim Rexhepi, nga Gazeta Fjala, Zekirija Shabani dhe Agon Sinanaj, në një prononcim për IKD, kanë thënë se nuk kanë pranuar asnjë informacion nga Prokurori i Shtetit lidhur me publikimin e dyshimeve të ngritura nga Hashim Rexhepi.

II. Përshkrim i rastit

Hashim Rexhepi ishte arrestuar me 23 korrik 2010, në cilësinë e Guvernatorit të BQK. Në njoftimin e EULEX-it, thuhej se arrestimi dhe bastisjet në BQK dhe lokacione tjera ishin të ndërlidhura me një hetim financiar për korrupsion ku dyshohej për keqpërdorim të detyrës apo pozitës zyrtare, marrje të ryshfetit, shmangie të tatimit, ushtrim të ndikimit dhe shpërlarje të parave.

Në dhjetor të vitit 2011, ish-Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Hashim Rexhepi ishte liruar si i pafajshëm nga ish-Gjykata e Qarkut në Prishtinë, pasi e kishte hedhur poshtë si të pabazuar aktakuzën ndaj ish-Guvernatorit Hashim Rexhepi. Ky i fundit, ishte mbajtur për katër muaj në paraburgim.

Lidhur me zhvillimet e ndodhura në vitin 2010, arrestimin e tij, lirimin e tij nga gjykata si të pafajshëm, gjatë muajit tetor të vitit 2016, ish-Guvernatori, Hashim Rexhepi, kishte rrëfyer në një intervistë për Gazetën Fjala, ndërhyrjet direkte në punën e Bankës Qendrore të Kosovës, nga njerëzit në pushtet. Ish-Guvernatori Rexhepi, ka denoncuar ndërhyrjet në BQK, të cilat sipas tij, ishin bërë nga Presidenti aktual ajo kohe ish-Kryeministri Hashim Thaçi dhe njerëzit e tij të afërt, e deri tek ish-Kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku dhe ish-Komandanti i përgjithshëm i UÇK-së Azem Sylja.

Rexhepi ka rrëfyer se gjithçka kishte filluar në vitin 2010 dhe rreth një takimi në Londër. Ai thotë se ata kanë gjithçka nën kontroll dhe vendosin se çfarë duhet bërë me paratë e taksave, e pensione ve të qytetarëve dhe kush duhet të përfitoj nga investimi i tyre. Në pothuajse të gjitha këto raste përmendet si akter kryesor edhe ish-Ministri i Financave të Kosovës, Ahmet Shala dhe Besim Beqaj, aso kohe Kryesues i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Shala madje del të jetë iniciator i takimit në Londër mes Hashim Rexhepit dhe këshilltarit izraelit të Hashim Thaçit, në vitin 2010 pak ditë para se Rexhepi të arrestohej. Ahmet Shala e kishte thënë ditën e parë të punimeve të konferencës që nesër në mbrëmje do ta kenë një takim me disa investitorë, duke i kërkuar që mos të planifikoi asgjë në agjendë. Por, në takim ministri e kishte lënë vetëm Hashim Rexhepin, duke i thënë se i ka dalur një punë. Në takim ishte paraqitur këshilltari izraelit i Thaçit. “Pasi morëm nga një pije, ai filloi bisedën. Me tha se Banka Qendrore menaxhon me mbi 1 miliard euro, dhe do të ishte mirë që t’i investoni në bankat që t’i propozoi unë, duke bërë me shenjë se të gjithë do të ndahemi të kënaqur, në kuptim

të përfitimeve materiale”. Rexhepi thotë ta ketë mohuar këtë ofertë, duke i thënë që ta harronte se kanë biseduar për një gjë të tillë.¹

Ish-Guvernatori Rexhepi, kishte denocuar edhe Sami Lushtakun dhe Azem Sylën, lidhur me ndërhyrjet e tyre në BQK.

Sipas rrëfimit në Gazetën Fjala, Kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, në vitin 2010, ia kishte bërë një vizitë të pazakontë – ish-Guvernatorit Hashim Rexhepi. Bashkë me ish-Ministrin e Financave Ahmet Shala, kishin hyrë në zyrën e Rexhepit për të kërkuar prej tij licencimin e kompanisë së sigurimeve “Europa Inc”, e cila ishte bllokuar për shkak të prejardhjes së dyshimtë të kapitalit dhe problemeve ligjore të aksionarëve. Kjo vizitë dhe një tjetër e Azem Sylës, më vonë për të punësuar njerëz të tij në BQK, ndodhën pak ditë para se t’i vinin në zyrë policia për ta arrestuar ish-guvernatorin Rexhepi. “Ka qenë një shembull i keq i ndërhyrjes në punën e BQK-së. Ahmet Shala dhe Sami Lushtaku kishin ardhur që të intervenojnë për licencimin e një kompanie sigurimi (Europa Inc.)”, kujton detaje nga ai takim, Rexhepi.²

Pak ditë para se të arrestohej, ish-Guvernatori Hashim Rexhepi, ishte informuar nga vartësit e tij për një investim të dyshimtë të parave të pensioneve në një institucion financiar jashtë vendit. “Shefja e zyrës për mbikëqyrje në atë kohë Shkëndije Himaj më njoftoi se ka vërejtur një investim të dyshimtë të Trustit në një institucion financiar me probleme”, ka deklaruar Rexhepi për gazetën Fjala. Bëhet fjalë për 75 milionë euro në Fondin “Fortis”, kompania amë e të cilit, në momentin kur u investuan mjetet, në vitin 2010, ishte pranë falimentimit dhe po mbahej në jetë vetëm falë ndërhyrjes së qeverisë belge.

Rexhepi pohon se me t’i marrë informatat, kishte urdhëruar stafin e tij për një inspektim të detajuar rreth këtij rasti.

Por ky hetim nuk u krye kurrë, ndërsa Rexhepi do të arrestohej me një mal akuzash për keqpërdorime. Pas qëndrimit katër muaj në burgim, Rexhepi u shpallë i pafajshëm nga të gjitha akuzat për të cilat ngarkohej.

Rexhepi thotë ta këtë nisur këtë hetim nën dyshimin se mund të jetë kurdisje e këshilltarit izraelit të kryeministrit Thaçi, Arie si dhe pas një takimi që kishte pasur me vetë kryeministrin Thaçi e tij. “Për habi, pas këtij takimi Trusti investoi rreth 75 milionë euro në një fond të Belgjikës i quajtur “Fortis”, e cila ishte nën intervenimin e qeverisë belge me mjete emergjente për shkak të krizës që e kishte goditur. Kurse disa muaj më vonë, Besim Beqaj u emërua Ministër i Ekonomisë në Qeveri”, rrëfen Rexhepi për Gazetën Fjala.

Në këtë takim, temë diskutimi sipas Rexhepit ka qenë investimi i parave të trustit në bankat jashtë vendit. “Në takim ishin Kryeministri Hashim Thaçi, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, ministri Ahmet Shala, kryetari i bordit të Trustit Besim Beqaj, drejtori i Trustit Ardian Zalli dhe unë”, tregon Rexhepi i cili këtë takim e ndërlihdh me atë paraparak me këshilltarin e

¹ Intervista në Gazetën Fjala: Autor: Zekirija Shabani dhe Agon SInanaj, në: <http://gazetafjala.com/analiza/rrefimi-i-erret-per-presidentin-thaci/>

² Intervista në Gazetën Fjala: Autor: Zekirija Shabani dhe Agon SInanaj, në: <http://gazetafjala.com/analiza/nderhyrjet-e-sami-lushtakut-dhe-azem-syles-ne-bqk/>

Thaçit në Londër, i cili i kishte kërkuar të investoheshin paratë e nën menaxhim të BQK-së në disa banka në Angli.

III. Gjetjet konkrete

- Përmbajtja e akuzave të ish-Guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, z. Hashim Rexhepi në drejtim të Presidentit aktual aso kohe Kryeministri Hashim Thaçi, këshilltarit të tij izraelit, ish-Kryetarit të Skenderajt, Sami Lushtaku dhe ish-Deputetit të Kuvendit të Kosovës, Azem Syla përbëjnë vepra të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, të cilat, me rastin e publikimit në media, duhet të hetohen sipas detyrës zyrtare.
- Kryeprokurori i Shtetit më 17 qershor 2015, në pajtim me nenin 11, pika 7 dhe neni 12 pika 3 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, kishte krijuar “Komisionin” për përcjelljen ditore dhe verifikimin e pretendimeve të rasteve të supozuara të krimit të organizuar e të korrupsionit, të publikuara përmes mjeteve elektronike e të shtypit, të parashtresave të qytetarëve dhe paraqitjeve publike të zyrtarëve të organeve e organizatave shtetërore e publike dhe të organizatave joqeveritare”. Autorët e intervistës me ish-Guvernatorin Hashim Rexhepi, nga Gazeta Fjala, Zekirija Shabani dhe Agon Sinanaj, në një prononcim për IKD, kanë thënë se nuk kanë pranuar asnjë informacion nga Prokurori i Shtetit lidhur me publikimin e dyshimeve të ngritura nga Hashim Rexhepi. Prokurori i Shtetit nuk është përgjigjur as në kërkesën e IKD-së, nëse është iniciuar ndonjë hetim për këtë rast.
- Publiku asnjëherë nuk është informuar nëse Prokurori i Shtetit ka ndërmarr veprime për të hetuar dyshimet e ngritura nga ish guvernatori Hashim Rexhepi.

IV. Pyetje publike

- A e ka trajtuar këtë rast Komisioni për përcjelljen ditore dhe verifikimin e pretendimeve të rasteve të supozuara të krimit të organizuar e të korrupsionit, të publikuara përmes mjeteve elektronike e të shtypit, të parashtresave të qytetarëve dhe paraqitjeve publike të zyrtarëve të organeve e organizatave shtetërore e publike dhe të organizatave joqeveritare?
- A kanë filluar hetimet parapenale apo penale lidhur me këtë rast?
- A ka ndërmarr Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ndonjë veprim lidhur me caktimin e këtij rasti tek PSRK?
- Pse ish-Kryeministri, tani Presidenti Hashim Thaçi nuk është përgjigjur në akuzat e Rexhepit?